

STATUT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TECH PRO” SH.P.K.

Sot, më datë 15.11.2019 (dymijë e nentebëdhjetë), u paraqiten:

Jacopo RANDICH, i biri i Eugenio dhe i Fiorenza, lindur me date 16.12.1966, ne Firenze Itali, dhe banues ne Rruga” G. Mazzini” Nr. 64, Pontedera (PI) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me – Leternjoftim ID me Nr. CA37886AK,

Simone BAGNOLI, i biri i Luciano dhe i Adriana, lindur me date 21.05.1967, ne Cascina (PI) Itali, dhe banues, Rruga” Corso G. Matteotti”, Nr.51, Pontedera (PI) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me – Leternjoftim ID me Nr. CA14990AL,

Të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

Kapitulli I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

N E N I 1
FORMA

- 1.1** Shoqëria **“TECH PRO” SH.P.K.** (në vijim shoqëria), ktijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rredullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2** Shoqëria vepron sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.
- 1.3** Statiti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin Shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni Shqiptar.



N E N I 2

Emërtimi

- 2.1** Emërtimi i shoqërisë është **“TECH PRO” SH.P.K.**

N E N I 3

Objekti i Shoqërisë

- 3.1** Aktiviteti i konsulencës, për shoqëri të të gjitha formave dhe sektorëve të veprimtarisë. Në vecanti në sektorët ekonomik, tregtar në favor të shoqërive të cilës do formë, entëve apo kompanive publike ose private, profesioneve të lira, punonjësve autonom, dhe të privatëce në përgjithësi. Konsulencë strategjike dhe organizative, për realizimin e projekteve të ristrukturimit dhe riorganizimit të mekanizmave të kontrollit dhe koordinimit të aktivitetit të shoqërisë, vlerësimin e riskut, elaborimin e planeve të shoqërisë, assistenzë tekniko-ekonomike për thithjen e financimeve dhe pjesmarrjen në gara publike, konsulencë për investime në itali dhe anasjelltas. Aktivitet assistues profesional, me qëllim zhvillimin industrial dhe tregtar, kërkim, angazhim, gjetje të klientëve potencial, mbledhje informacini, hetim/kërkim social-ekonomike, realizimin e analizave dhe kërkimin e tregjeve, angazhimin dhe prezantim të kushteve më të mira të tregut. Cdo lloj aktiviteti që ka të bëjë me sektorin publicitar/reklama, marketingut dhe të komunikimit, studimit, projektimit, zbatimin e fushatave publicitare, kërkim tregu, promovimin e shitjeve, marrëdhënieve publike. Projektimin dhe realizimin e stendave dhe banerave për panairë apo pika shitjesh, kërkimi dhe furnizimi i materialeve publicitare, aktivitet blerje dhe planifikim të hapsirave publicitare në shtyp, radio, televizion, afishim, dhe internet. Brokerim sigurues, ndërmjetësim ndërkombëtar të cilësdo natyrë.

N E N I 4

Selia

- 4.1** Selia e shoqërisë do të jetë: Njesia Administrative Nr.7, Rruga “Astrit Sulejman Balluku” Nr. 8, Tiranë.

N E N I 5

Kohëzgjatja

- 5.1** Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë më një afat të paktuar.



- 5.2 Shoqëria mund të prishë përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Kapitulli II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUATOVE

N E N I 6


Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10000 (dhjetëmijë) lekë.
- 6.2 Kapitali i themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të nënshkruara me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

N E N I 7

Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Ortaku **Jacopo RANDICH** i cila ka kontribuar në kapitalin fillestar të shoqërisë me vlerën prej 5000 lekë (pesëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimit e sipër.
 - Ortaku **Simone BAGNOLI** i cila ka kontribuar në kapitalin fillestar të shoqërisë me vlerën prej 5000 lekë (pesëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimit e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
- Ortakut **Jacopo RANDICH**, i përket një kuotë, me vlerën nominale LEKË 5000 (pesëmijë) që i korrespondon 50% të kapitalit të shoqërisë.
 - Ortakut **Simone BAGNOLI**, i përket një kuotë, me vlerën nominale LEKË 5000 (pesëmijë) që i korrespondon 50% të kapitalit të shoqërisë.



N E N I 8
Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1** Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në cdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2** Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë Ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar.

N E N I 9
Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1** Shoqëria mund të zvogëloj kapitalin themeltar me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2** Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

N E N I 10
Transferimi i kuotave

- 10.1** Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2** Në rast transferimi në cdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjërë të fjalës, duke përfshirë këtu dhe dhurimin në favor të subjekteve të tretë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet ti ofrohen më parë në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3** Në një rast të tillë, ortaku që do duhet të transferoj kuotën/tat e tij, do të duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje duke përcaktuar cmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes do të duhet t'i ofrohet të gjithë kuotës të ofruar për shitje.
- 10.4** Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ai/ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5** Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuota/tat mund t'i ofrohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendim pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.6** Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie mortis causa, ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi,kuotat mund t'i transferohen të

tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të thjeshtë.

Kapitulli III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORI, DHE EKSPERTI KONTABËL

N E N I 11

Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1** Organi Vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2** Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve në çështjet vijuese:
- Ndryshimin e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër të parashikuar nga ky Statut dhe nga legjislacioni përkatës.

N E N I 12


E drejta e pjesmarrjes dhe e votës

- 12.1** Çdo ortak, ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ai zotëron.
- 12.2** Cdo ortak, ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë të shkruar, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3** Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, nëqoftëse voton personalisht për pjesën e mbetur.

N E N I 13

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Votimet


- 13.1** Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 120 (njëqindnjëzetë) ditëve kalendarike nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.



- 13.2** Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej administratorëve apo administratorit të vetëm, si dhe nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 50 % të kapitalit themeltar.
- 13.3** Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton sipas këtij Statuti- dhe ekspertit Kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.
- 13.4** Thirrja duhet të përmbaj informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vëndin, orën, dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.5** Asambleja mund të thirret dhe jashtë selisë së Shqipërisë, pra edhe në Itali.
- 13.6** Asambleja do të thirret dhe të mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7** Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për emerimin dhe shkarkimin e Administratorit, apo cdo vendimmarrje tjetër të rëndësishme që kërkon shumicë të cilësuar, nga momenti që kuotat janë ndarë 50% me 50%, do të duhet të jenë të dy ortakët dakord.
- 13.8** Cdo asamble drejtohet nga 1 (një) ortak apo cdo person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit, Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo -ortak.
- 13.9** Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

N E N I 14 **Administrimi**

- 14.1** Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndroj në detyrë deri në shkarkimin apo dorëheqjen, për një periudhë 5 (PESE) vjecare. Administratorët do të emërohen nga Asambleja me votë unanime të të gjithë ortakëve.
- 14.2** Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha kompetencat konform parashikimeve të nenit 95 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " të ndryshuar, përvec sa parashikohet në pikën 14.3 në vijim.
- 14.3** Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të Ligjit Nr. 9901, datë 14. Prill.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe nenit 14 të Statutit.



- 14.4** Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të hkittha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- 14.5** Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve apo konsulentëve të cilëve mund t'u delegohet tërësia apo pjesërisht kryerja e aktivitetit të sipërpërmëndur.
- 14.6** Administratori është gjithashtu i autorizuar të veproj në emër të shoqërisë në formim e sipër deri në rregjistrimin e saj pranë QKB-së.
- 14.7** Ai është gjithashtu i autorizuar të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrimet në emër të shoqërisë që rrjedhin prej momentit të rregjistrimit të saj.
- 14.8** Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori/ët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- 14.9** Ai zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
- 14.10** Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori veprimesh të caktuara.

N E N I 15

Eksperti Kontabël i autorizuar

- 15.1** Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të shoqërisë mund t'i besohen një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2** Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në cdo kohë sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Kapitulli IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

N E N I 16

Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1** Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhejetor të secilit vit.
- 16.2** Viti i parë financiar fillon në datën e rregjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Biznesit) dhe përfundon në datë 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe Ekspertit Kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e



- kërkuar nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 16.4** Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 120 ditëve që nga fundi i vitit financiar.

N E N I 17

Fitimet

- 17.1** Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor u shpërndahen ortakëve në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit themeltar të zotëruar.
- 17.2** Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht apo pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Kapitulli V

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

N E N I 18


Prishja

- 18.1** Shoqëria priset në përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në Statut.
- 18.2** Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentit të ortakëve.

N E N I 19

Likujdimi

- 19.1** Në rast prishje, shoqëria duhet të likujdohet.
- 19.2** Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron 1 ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjëndjen e aktivëve dhe pasivit të shoqërisë, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimin.



- 19.3** Në përfundim të procedurës së likujdimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likujduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likujdimit.
- 19.4** Pas pagimit të kredive dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likujdimit Ortakëve, në proporcion me vlerën nominale të kuotës të zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

N E N I 20
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1** Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtis Statuti, si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve, do të zgjidhen në mënyrë miqësore.
- 20.2** Në rast se nuk do të arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, trajtimi i tyre do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

N E N I 21
Gjuha

- 21.1** Ky Statut është hartuar në 4 kopje në gjuhën Shqipe me shtojcë përkthimi në gjuhën Italiane.
- 21.2** Nëse do këtë mosmarrëveshje interpretimi, versioni Italisht do të jetë i vetmi ligjërishit detyrues.

STATUT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PROTECH” SH.P.K.
ORTAKËT

Jacopo Randich

JACOPO RANDICH

Simone BAGNOLI

Simone Bagnoli

SIMONE BAGNOLI